



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK  
GRAMSH

Nr. 1642/2 Prot.

Gramsh më 28.05 /2024

VENDIM

Nr. 36 Datë 29.04.2024

Për miratimin e nje siperfaqe trualli prej 540 m<sup>2</sup> (pesëqind e dyzet ) metra katrorë,pjesë e pasurise 8/132, Zonë kadastrale 1842 e cila eshte ne pronësi te Bashkise Gramsh, si truall per ndertimin e objektit, qe do te ndertohet nga Enti Kombëtar i Banesave (EKB) me kosto te ulet, për qëllime strehimi.

Këshilli i Bashkisë Gramsh, ne mbledhjen e tij te dates 29/04/2024,pasi shqyrtoi materialet e paraqitura nga Drejtoria e Planifikimit,Zhvillimit dhe Mbrojtjes se Territorit bazuar ne ligjin nr. 139,date 17/12/2015 “ Per veteqeverisjen vendore”,nenet 24,pika 2 dhe 54,gërma ‘e’; ligjin nr. 107/2014,date 01/10/2014 i ndryshuar “ Për Planifikimin Dhe Zhvillimin e Territorit” ; VKM-në nr.408,date 13/05/2015 i ndryshuar “ Për Miratim e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”...

VENDOSI :

1. Te miratoj nje siperfaqe trualli afersisht prej 540 m<sup>2</sup> (pesëqind e dyzet ) metra katrorë pjese e pasurise nr.8/132, Zona Kadastrale 1842 e cila eshte ne pronesi te Bashkise Gramsh si truall për ndertimin e e objektit, qe do te ndertohet nga Enti Kombëtar i Banesave (EKB) me kosto te ulet, për qëllime strehimi sipas hartes dhe planit te rilevimit bashkelidhur ketij vendimi.
2. Siperfaqja e truallit sipas pikes 1 (një) te ketij vendimi i jepet ne perdorim Entit Kombëtar te Banesave (EKB) ne funksion te ndertimit te objektit me qëllim strehimin e banoreve te gjendur apo te deklaruar pa nje strehim.
3. Për zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn ne fuqi pas miratimit te tij nga institucioni i Prefektit te Qarkut Elbasan.

KRYETARI I KËSHILLIT

ENIS ZANI



Sel. Këshillit  
Dr. Al. Temizani



BASHKIA GRAMSH  
RREGJ 1642/  
Mbërrit me Dute

16.05.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN  
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 573/prot.

Elbasan, më 15.5.2024

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK GRAMSH

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.36 datë 29.04.2024 "Për miratimin e një sipërfaqe trualli prej 540m<sup>2</sup> (pesëqind e dyzet) metra katrorë, pjesë e pasurisë 8/132, Zonë kadastrale 1842 e cila është në pronësi të Bashkisë Gramsh, si truall për ndërtimin e objektit që do të ndërtohet nga Enti Kombëtar i Banesave (EKB) me kosto të ulët për qëllime strehimi" konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Majlinda PERRIU

